

## **Qendra për Zhvillim dhe Integrim Europian- CEDI**

**Titulli i Projektit:** Meritokracia në fokus për një sistem gjyqësor të drejtë, transparent dhe të pavarur.

**Qëllimi kryesor i projektit** është të sigurohet që emërimi i gjyqtarëve në Shqipëri të ndjekë rreptësisht parimin e meritokracisë për një sistem gjyqësor të drejtë, transparent dhe të pavarur.

Të drejtat themelore të parat: një sistem gjyqësor i pavarur dhe i paanshëm.

### **Objektivat specifike të projektit janë:**

- **OS1:** Vlerësimi i plotësimi të kriterëve për emërimin e gjyqtarëve dhe transparencës së zbatuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- **OS2:** Forcimi i advokimit për përmirësimin e aplikimit të standarteve të meritokracisë në karrierat gjyqësore nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

### **Grupi drejtëpërdrejtë i synuar:**

- 15-20 gjyqtarë që do të vlerësohen gjatë zbatimit të projektit;
- 25-30 organizata të Shoqërisë Civile në Tiranë, Shkodër & Korçë,
- 20-25 profesionistë ligjorë të cilët do të marrin pjesë në masat advokuese

### **Rezultatet e pritura:**

**Rezultati 1:** Përmirësimi i qartësisë dhe transparencës së standarteve të promovuara, aplikuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

**Rezultati 2:** Forcimi i advokacisë dhe angazhimit publik për një sistem gjyqësor të drejtë, transparent dhe të pavarur.

Qytetarët shqiptarë do të përfitojnë në terma afatgjatë – një sistem gjyqësor profesional dhe të pavarur.

### **Aktivitetet dhe Produktet:**

**Aktiviteti 1.** Monitorimi i aplikimeve të standarteve të meritokracisë në emërimin e magjistratëve nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

- ❖ *Vlerësim fillestar apo paraprakë*
- ❖ *Gjashtë muaj monitorim i KLGJ*
- ❖ *Finalizimi i Raportit Monitorues për KLGJ& prezantimi i gjetjeve*

**Produkti:** Raporti i monitorimit – Monitorimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi emërimin e magjistratëve.

**Aktiviteti 2. Advokim me OJF dhe profesionistët e drejtësisë**

2 tryeza të rrumbullakëta - Forume - shpërndarja e gjetjeve të raportit dhe rrugët që duhet të ndjekim për të advokuar për një sistem gjyqësor të pavarur të bazuar në meritokraci.

Bisedë në mediat lokale